



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13.1.2025

Nr: 13

VENDIM

PËR
EMËRIMIN E AUDITIT TEKNICIEN PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE SI DHE LISTAVE TË ZGJEDHËSVE ME
BANIM JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND
TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të shkronjës “n” të pikës 1 të nenit 19, pika 11 e nenit 25 dhe pikat 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Emërimin e z. Ervin Bana audit teknikien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve si dhe listës së zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Caktimin e masës së shpërblimit në vlerën 460 000 (katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për auditin teknikien për periudhën nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raporteve përfundimtare.
3. Ngarkohet auditi teknikien të propozojë ndihmësin/it përkatës brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 13.1.2025 Nr: 13



“Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”